



## FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

### POLITIKA PËR SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË DREJTORËVE

#### 1. Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo Politikë është hartuar në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, si dhe qëllimi i saj është të krijojë kornizën për të siguruar proces të drejtë dhe të ligjshëm për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të FKGK-së. Ajo përcakton mënyrat në të cilat FKGK mëton të ofrojë trajtim të drejtë për të gjithë anëtarët. Një synim tjetër paralel i kësaj politike është të ruajë integritetin dhe reputacionin e FKGK-së.

#### 2. Parimet

1. Asnjë shkarkim nuk merr efekt pa i dhënë mundësi Anëtarit të Bordit për t'u sqaruar dhe për të ndjekur dëgjimin për të.
2. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ndërpritet sipas ligjit për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
3. Në rastet kur zbatohet pika 2 e nenit 2 të kësaj Politike, hapat proceduralë për ndërprerjen formale të mandatit të Anëtarit të Bordit do të ndërmerren nga Bordi i Drejtorëve.

#### 3. Arsyet për shkarkim

1. Cilido anëtar i Bordit shkarkohet për cilëndo prej arsyeve vijuese, sipas veprimit të Ligjit:
  - a. Është i papranueshëm ose është bërë i papranueshëm për të shërbyer në Bordin Menaxhues sipas kërkesave të nenit 16 të Ligjit për FKGK-në;
  - b. Është dënuar për vepër penale me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me burgim për gjashtë (6) muaj apo më shumë;
  - c. Është bërë apo është angazhuar si debitor në procedurë bankrotimi apo paaftësie pagese;
  - d. Në baza të kundërvajtjes profesionale, është diskualifikuar apo i është pezulluar ushtrimi i profesionit nga një autoritet kompetent;
  - e. Nuk është në gjendje të ushtrijë funksionet e atij mandati për shkak të paaftësisë mendore apo trupore që ka zgjatur për më shumë se gjashtë (6) muaj;

- f. Ka munguar në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit të Drejtorëve pa arsytim të qëndrueshëm.
2. Anëtari i Bordit shkarkohet për arsye të tjera përveç atyre të përcaktuara me ligj, të cilat do të diskreditonin Fondin, siç mund të jenë konflikti i interesit dhe/ose neglizhenca e rëndë në ushtrim të detyrave.

#### 4. Procedura e shkarkimit

Anëtari i Bordit mund të rekomandohet për shkarkim në pajtim me procesin e duhur vijues:

- a. Plotësimi i ankesës: procedurë e rekomandimit të shkarkimit të një anëtari të Bordit që inicohet nga Këshilltari Kryesor i FKGK-së si dhe i paraqitet Kryetarit për procedim në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.
- b. Njoftimi për ankesë: njoftimi për ankesë ndaj një anëtari të Bordit i komunikohet atij anëtari të Bordit ndaj të cilit është parashtruar ankesa nga Kryetari. Njoftimi i tillë bëhet me shkrim.
- c. Me pranimin e ankesës me shkrim, Kryetari i Bordit thërret mbledhjen dhe inicion procesin e votimit.
- d. Vendimi për konfirmimin e shkarkimit merret me shumicë votash të anëtarëve të Bordit të pranishëm në mbledhje. I gjithë procesi shqyrtohet nga Këshilltari Kryesor/Këshilltari Ligjor i FKGK-së për të siguruar respektimin e mirëfilltë të procesit dhe dokumentimin adekuat të tij.

Në rastin e një anëtari ex-officio që është përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo Ministrisë së Financave, vendimi i Bordit i komunikohet Ministrisë përkatëse.

#### 7. Zbatimi i kësaj Politike

Kjo Politikë është vendosur për të siguruar funksionimin e rregullt të FKGK-së si dhe për të vendosur rregullat e brendshme të sjelljes dhe të standardeve profesionale që kërkohen nga Anëtarët e Bordit të FKGK-së. Në çdo situatë ku ka kundërthënie ndërmjet Politikës dhe ligjit në fuqi, ligji në fuqi mbizotëron.

## 8. Ndryshimet

Kjo Politikë do të shqyrtohet dhe ndryshohet e plotësohet kohë pas kohe, ndërsa FKGK-ja rezervon të drejtën për të modifikuar e ndryshuar kushtet për plotësimin e rrethanave të ndryshuara, apo për të siguruar përputhshmërinë me ligjet në fuqi.

## 9. Përputhshmëria dhe sanksionet

Anëtarët e Bordit të FKGK-së mbajnë përgjegjësi individuale për kuptimin dhe respektimin e kësaj Politike. Shkeljet e kësaj Politike si dhe rregullave e ndalesave të lartpërmendura mund të pasojnë me masa disiplinore ndaj Anëtarëve të Bordit.